

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Sadije Selmani, me procesmbajtësen Luljeta Luboteni – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarve B.D dhe M.D që të dy nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale, sulm nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-së dhe A.R, E.R dhe A.R që të gjithë nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale, sulm nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2929-3/16 të datës 20.03.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit-Zejnullah Gashi dhe të akuzuarve, me datë 13.09.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. B.D, nga i ati R.. dhe e ëma R., e vajzëris ..., i lindur me ..., në..., tani jeton në fshatin ..., Komuna e ..., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar, gjendjes së mesme ekonomike, boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal

2. M.D, nga i ati nga i ati R.. dhe e ëma R., e vajzëris ..., i lindur me ..., në ..., tani jeton në fshatin ..., Komuna e ..., ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i martuar, i ati i një fëmiju, i gjendjes së mesme ekonomike, boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal

3. A.R, nga i ati A.. dhe e ëma A., e vajzërisë ..., i lindur me ..., në fshatin ..., Komuna e ..., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i martuar, i ati i katër fëmijëve i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal

4. E.R, nga i ati A.. dhe e ëma F., e vajzërisë ..., i lindur me ..., në Prizren, tani jeton në fshatin ..., Komuna e ..., student, i papunë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal

5. A.R, nga i ati A.. dhe e ëma F., e vajzërisë R., i lindur me ..., në ..., tani jeton në fshatin ..., Komuna e ..., ka të kryer fakultetin, punëtor, i martuar, i ati i një fëmiju, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal

JANË FAJTORË

Të akuzuarit: B.D dhe M.D

I. Se me datë 06.10.2016, rreth orës 21:00, në fshatin ..., Komuna e ..., me dashje i sulmojnë të dëmtuarit A.R, E.R dhe A.R, në atë mënyrë që derisa A.R ishte duke pirë kafe në një kafe-qajtore të fshatit , hynë në lokal B.D, i cili nga pas e godet në kokë me shuplakë, ku pas pak vijnë edhe djemtë e të dëmtuarit A.R dhe E.R, të cilët afrohen afër

tavolinës së të pandehurve, me ç'rast fillojnë ta godasin njëri tjetrin, mirëpo nuk pësojnë lëndime të dukshme trupore.

Këso dore në bashkëkryerje kan kryer veprën penale, sulm nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Të akuzuarit: A.R, E.R dhe A.R

II. Se me datë, kohë, vendë dhe mënyrë të njëjtë të përshkruar si në dispozitivin e parë të aktakuzës, me dashje i sulmojnë të dëmtuarit B.D dhe M.D, mirëpo sipas akt ekspertimit të ekspertit mjeko ligjor Dr.V.H të dt.10.12.2016, nuk pësojnë lëndime të dukshme trupore.

Këso dore në bashkëkryerje kan kryer veprën penale, sulm nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëshënuara dhe neneve 4, 7, 17, 41, 42, 49 par.1 nënpar.1.1, 50, 51, 52, 73 të KP-së dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarve u shqipton:

Të akuzuarit B.D

- Për veprën penale nën I. të dispozitivit, dënim me kusht duke i vërtetuar, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit prej 1 (një) viti, nga flotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

Të akuzuarit M.D

- Për veprën penale nën I. të dispozitivit, dënim me kusht duke i vërtetuar, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit prej 1 (një) viti, nga flotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

Të akuzuarit A.R

- Për veprën penale nën II. të dispozitivit, dënim me kusht duke i vërtetuar, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit prej 1 (një) viti, nga flotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

Të akuzuarit E.R

- Për veprën penale nën II. të dispozitivit, dënim me kusht duke i vërtetuar, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit prej 1 (një) viti, nga flotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

Të akuzuarit A.R

- Për veprën penale nën II. të dispozitivit, dënim me kusht duke i vërtetuar, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit prej 1 (një) viti, nga flotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohen të akuzuarit B.D, M.D, A.R, E.R dhe A.R që t' i paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe ate: në emër të ekspertizës mjeko ligjore solidarisht duhet të paguajnë shumën prej 50 euro, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej nga 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.2929-3/16 të datës 20.03.2017, kundër të akuzuarve B.D dhe M.D që të dy nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale, sulm nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-së dhe A.R, E.R dhe A.R që të gjithë nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale, sulm nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Në shqyrtimin fillestar të gjithë të akuzuarit kanë pranuar fajësinë për veprat penale, që u vihen në barrë sipas aktakuzës së PTH-së në Prizren.

Gjykata nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se të akuzuarit B.D dhe M.D, me datë 06.10.2016, rreth orës 21:00, në fshatin ..., Komuna e ..., me dashje i sulmojnë të dëmtuarit A.R, E.R dhe A.R, në atë mënyrë që derisa A.R ishte duke pirë kafe në një kafe-qajtore të fshatit , hynë në lokal B.D, i cili nga pas e godet në kokë me shuplakë, ku pas pak vijnë edhe djemtë e të dëmtuarit A.R dhe E.R, të cilët afrohen afër tavolinës së të pandehurve, me ç' rast fillojnë ta godasin njëri tjetrin, mirëpo nuk pësojnë lëndime të dukshme trupore.

Gjithashtu në tërësi u vërtetua se të akuzuarit A.R, E.R dhe A.R, me datë, kohë, vendë dhe mënyrë të njëjtë të përshkruar si në dispozitivin e parë të aktakuzës, me dashje i sulmojnë të dëmtuarit B.D dhe M.D, mirëpo sipas akt ekspertimit të ekspertit mjeko ligjor Dr. V.H të dt.10.12.2016, nuk pësojnë lëndime të dukshme trupore.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit B.D, M.D, A.R, E.R dhe A.R, të cilët në shqyrtimin fillestar, vullnetarisht kanë pranuar fajësinë, për veprat penale për të cilat akuzohen, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Gjykata sipas detyrës zyrtare nuk ka gjetur se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se të akuzuarit, kan kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprat penale të cilat u vihen në barrë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e tyre, se pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza dhe se të akuzuarit prej fillimit të hetimeve e gjerë në këtë shqyrtim kan qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat i ka paraqitur përfasuesi i aktakuzës dhe të cilat asnjëherë nuk i kan kundërshtuar dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale të përshkruara si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe ti gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësin e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KP-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethana lehtësuese për të gjithë të akuzuarit gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e tyre, pendimin dhe premtimin se asnjëherë në të ardhmen nuk do të kryejnë veprime të kundërligjshme, sjelljen e tyre korrekte gjatë procesit gjyqësor, keqardhjen e shprehur nga ana e tyre dhe kërkim faljen ndaj njëri tjetrit dhe poashtu pajtimin mes familjeve si dhe sjelljen e tyre pas kryerjes së veprave penale. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit dhe se kto dënime të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se në të ardhmen dënimet e tilla të shqiptuara do të parandalojnë kryesit si dhe personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 dhe 453 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.595/2017 me datë 13.09.2017

Procesmbajtësja
Luljeta Luboteni

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Sadije Selmani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.